

# Ligji për ndihmë dhe shërbim për disa persona me pengesa funksionale (shkurtimisht në gjuhën suedese – LSS)

## Çështë ligji për ndihmë dhe shërbim - LSS?

Ligji për ndihmë dhe shërbim për disa persona me pengesa funksionale [*Lagen om stöd och service till vissa funktionshindrade*] (LSS) është një e drejtë ligjore me an të së cilës u garantohen personave që kanë pengesa të mëdha dhe të qëndrueshme funksionale kushte të mira për jetesë, të marrin ndihmën për të cilën kanë nevojë në jetën e përditëshme, si dhe të ndikojnë në atë se cilën ndihmë dhe cilin shërbim do ta marrin. Kërkesa për ndihmë dhe shërbim nga një person që hynë në të ashtuquajturin “qark personal” [*personkrets*] të ligjit, duhet në radhë të parë të shqyrtohet sipas këtij ligji, nëse është një kontribut që rregullohet në këtë ligj. Supozohet se arsyeja për këtë në përgjithësi është që individi të ketë përparësi. Sipas ligjit kontributet i takojnë individit, nëse ai personalisht e kërkon këtë.

## Kush ka të drejtë për kontribute sipas LSS?

Për ta gëzuar të drejtën për kontributet në këtë ligj, kërkohet që personi t'i përkas “qarkut personal” siç qëndron në ligjë. Ai ose ajo do të ken nevojë për këtë ndihmë për mënyrën e vet të jetesës, si dhe kjo nevojë të mos plotësohet në ndonjë mënyrë tjetër.

Ligji vlen për:

1. Personat me pengesa në zhvillim dhe persona që vuajn nga autizmi (sëmundje) ose një gjendje e ngjashme me autizmin.
2. Personat me prirje të qëndrueshme dhe të rënda të pengesave funksionale pas lëndimit të trurit në moshën e rritur që është shkaktuar nga dhuna e jashtme ose sëmundja trupore.
3. Personat që si pasojë nga pengesat funksionale të qëndrueshme dhe të mëdha fizike ose psikike, e cila qartë nuk varet nga pleqëria normale, ka vështirësi të mëdha në jetën e përditëshme dhe nevojë të madhe për ndihmë dhe shërbim.

## Dhjet të drejta/kontribute që gjinden në ligjin për “qarkun personal” është sa vijon:

### 1. Këshillim dhe përkrahje tjetër individuale

[*Rådgivning och annat personligt stöd*]

Ai i cili i takon “qarkut personal” ka të drejtë në një përkrahje nga ekspert të klasifikuar, persona të cilët përveç ditoris profesionale kanë edhe ditori të veçant sa i përket asaj se si është të jetohet me pengesa të mëdha funksionale. Përkrahja mund të jepet p.sh nga këshilltari [*kurator*], psikologu, terapi-fizike [*sjukgymnast*], logoped (specialist për të ushtruar personat që kanë pengesa në të folurit), terapeut-pune [*arbetsterapeut*] dhe dietisti (këshilltar për ushqim). Këshillat dhe përkrahja do të jenë



edhe një shtojcë më tepër, dhe jo një kompensim p.sh habitim ( përshtatja e invalidëve në një jetë normale), rehabilitim (përshtatja në një jetë normale p.sh pas një sëmundje të rëndë), dhe shërbim social.

## **2. Asistim personal [Personlig assistans]**

Personat me dobësi të mëdha funksionale të cilët ende nuk i kanë 65 vjet, kanë të drejtë në ndihmës [biträde], prej një deri në disa asistent personal.

Për të pasur të drejtë në "asistim personal" duhet të ekzistoj nevoja për ndihmë me higjienë personale, me ushqim, me veshje dhe zhveshje, me komunikim me të tjerët ose nevojë për ndonjë ndihmë tjetër që mund të supozohet nga njohurit e hollësishme për atë person me pengesa funksionale.

Asistimi mund të sigurohet përmes komunës ose merr ndihmë ekonomike dhe personalisht bëhet punëdhënës ose angazhon dikënd të kryej punën.

Komuna mban përgjegjësin e tërë ekonomike për atë person që ka nevojë për asistim më pak se 20 orë në javë. Nëse nevoja për asistim personal, duke u bazuar në nevojat themelore është më tepër se 20 orë në javë, personi ka të drejtë të marr kompensim për asistim [assistansersättning]. E drejta për këtë kompensim merret sipas një ligji tjetër që quhet Ligji për kompensim të asistimit [Lagen om assistansersättning] (LASS).

Për kompensim të asistimit vendos Arka e sigurimit [Försäkringskassan]. Në raste të këtylla të vendimeve, komuna ka përgjegjësin ekonomike për ato 20 orët e para.

Për persona me dobësi të mëdha funksionale [stora funktionsnedsättningar] që kanë 65 vjet, vlenë të ken ose të ken pasur asistim personal para se të bëhen 65 vjeç ose të ken dorëzuar kërkesën për asistim personal para se të bëhen 65 vjeç. Ndërkaq asistimi personal nuk mund të rritet (zmadhohet) pasi që personi është bërë 65 vjeç.

## **3. Shërbimi përcjellës [Ledsagarservice]**

Të drejtë për shërbim përcjellës ka ai i cili nuk ka asistim personal. Shërbimi përcjellës duhet të jetë një shërbim personal [personlig service], i përshtatur sipas nevojave individuale për të lehtësuar individit të marr pjesë në jetën shoqërore.

## **4. Personi kontaktues [Kontaktperson]**

Për të zvogëluar izolimin social jepet ndihmë për të marr pjesë në aktivitete të kohës së lirë [fritidsaktiviteter], si dhe jepen këshilla për situata të përditëshme dhe për këtë arsye ndonjë herë nevojitet ndihma e një personi kontaktues. Personi kontaktues mund të lehtësoj për individin që të jetoj një jetë të pavarur. Ndonjë herë përkrahja mund të jepet nga një familje, e ashtu quajtur "familje përkrahëse" [stödfamilj].

## **5. Shërbim këmbyes (zëvendësim) në shtëpi [Avlösarservice i hemmet]**

Shërbimi këmbyes merret si një kontribut i rregullt si dhe për situata të cilat nuk mund të parashikohen.

## **6. Qëndrimi për kohë të shkurtër jashtë shtëpis së vet**

[Korttidsvistelse utanför det egna hemmet]

Qëndrimi për kohë të shkurtër është për t'iu dhënë mundësia individit për pushim (çlodhje) dhe ndërrim të ambientit, njëkohësisht edhe të afërmit kanë mundësi për



këmbim (zëvendësim) [*avlösning*]. Qëndrimi për kohë të shkurtër mund të rregullohet në “shtëpi- për kohë të shkurtër” [*korttidshem*] në një familje tjetër ose në ndonjë mënyrë tjetër p.sh pushimore (kamp) [*läger*], ose qëndrim në koloni (pushimore fëmijësh) [*kolonivistelse*].

### **7. Mbikëqyrje për kohë të shkurtër për rini shkollore mbi 12 vjeç**

[*Korttidstillsyn för skolungdom över 12 år*]

Rinia shkollore mbi 12 vjeç mund të ken mbikëqyrje para dhe pas ditës-shkollore si dhe gjatë pushimit veror.

### **8. Banim në shtëpi- familje ose banesë me shërbim të veçant për fëmijë dhe rini**

[*Boende i familjehem eller i bostad med särskild service för barn och ungdom*]

Fëmijët dhe rinia të cilët nuk mund të banojnë tek prindërit e vet kan të drejtë të banojnë tek një familje tjetër ose në një banesë me shërbim të veçant. Kjo do të jetë një nddihmesë (shtojcë) për shtëpin e prindërve [*föräldrahemmet*] edhe për fëmijë të cilët mund të banojnë tek prindërit një pjesë të kohës dhe për ata të cilët nuk mund të banojnë ne shtëpi fare.

### **9. Banim me shërbim të veçant për të rritur ose banesë tjetër me përshtatje të posaçme**

[*Boende med särskild service för vuxna eller annan särskilt anpassad bostad*]

Banimi mund të formulohet në mënyra të ndryshme, mirëpo format më të zakonshme janë banim-kolektiv [*gruppbostad*], dhe banesë invalidësh [*servicebostad*]. Individu mund të ket të drejtë gjithashtu të marr një banesë me përshtatje të posaçme të rekomanduar [*anvisad*] nga komuna.

### **10. Veprimtari e përditshme** [*Daglig verksamhet*]

Personat që kan moshën për ta ushtruar profesionin, të cilëve iu mungon puna (puna që sjell dobi) [*förfärvsarbete*] dhe nuk shkollohen, kanë të drejtë në veprimtari të përditshme nëse ata i përkasin “qarkut personal” 1 dhe 2 sipas LSS.

## **Shpenzimet** [*Kostnad*]

Në parim këto kontribute të veçanta janë pa pagesë për individin, mirëpo ekzistojnë disa përjashtime.

## **Plani individual** [*Individuell plan*]

Atij, të cilit i lejohet ndihma, në bazë të ligjit mund të kërkoj një plan individual në të cilin ndihmat e vendosura dhe të planifikuara do të raportohen. Planifikimi duhet të bëhet së bashku me atë person i cili e merr ndihmën.

Kur një person me pengesa funksionale merr një ndihmë, në bazë të ligjit mund ai/ajo të kërkoj të hartohet një plan individual së bashku me atë/ate [*honom/henne*].

Individi ka mundësi të prij (udhëheq) se çka do të përmban plani, cilët ose kush do të marrin pjesë, si dhe ka mundësi për ta shpreh dëshirën dhe nevojën. Një plan përmban gjithashtu edhe mënyrën se si do të arrihet deri te ajo që një person dëshiron. Plani duhet të përmbaj edhe ndihmë për të harmonizuar të gjitha kontaktet.



Plani mund të përmban:

- Përshkrim i shkurtër i situatës familjare, për të ardhmën p.sh. kur fillon mësimi etj.
- Ndhimat të cilat jepen tani.
- Ndhimat të cilat nevojiten / do të nevojiten.
- Ndhimat të cilat familja i dëshiron.
- Çka pjesëmarësit e ndryshëm (duke përfshirë familjen) duhet të bëjnë dhe kur.
- Çfarë nevoja ka familja? (Nuk duhet harruar motrat dhe vëllezërit!)
- Si dëshirojmë ne të marrim ndihmën?

Kjo e cila qëndron në plan nuk paraqet vendimin të lejohet një ndihmë. Plani duhet përcjell, zakonisht çdo vjet.

### **Kërkesa [Ansökan]**

Gjdo komunë ka një LSS-referent (asistent) të veçant ose referent për ndihma me përgjegjësi ndaj LSS. Kërkesa mund të bëhet me shkrim, mirëpo mund të paraqitet edhe me gojë gjat takimit me referentin (asistentin). Personi me pengesa funksionale duhet të qëndroj si kërkues.

### **Më tepër informata [Mer information]**

Ligji (1993:387) për ndihmë dhe shërbim për disa persona me pengesa funksionale.

*[Lag (1993:387) om stöd och service till vissa funktionshindrade]*

Propozim (1992/93:159) për ndihmë dhe shërbim për disa persona me pengesa funksionale.

*[Proposition (1992/93:159) om stöd och service till vissa funktionshindrade]*

